



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 51, datë 21.03.2012

PËR
MIRATIMIN E PAGESËS NË TITUJ TË KUOTAVE TË FONDIT TË
INVESTIMIT “RAIFFEISEN PRESTIGJ” NGA INVESTITORI RAIFFEISEN
BANK

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, Ligjit nr. 9572 datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Rregullores nr. 50, datë 21.02.2012 “Mbi rrethanat e veçanta për pagesën në tituj të kuotave të fondit të investimit” me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Këshilli i Administrimit të Shoqërisë “Raiffeisen Invest - shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” në mbledhjen e datës 15.03.2012 vendosi të miratojë kërkesën e Investitorit “Banka Raiffeisen” për pagesën në letra me vlerë të qeverisë të kuotave të fondit të investimit “Raiffeisen Prestigj”.

“Banka Raiffeisen”, me shkresën nr. 2480, datë 16.02.2012, ka vënë në dijeni Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në lidhje me strategjinë e saj për të investuar në Fondin e Investimeve “Raiffeisen Prestigj” duke synuar t’i japë një mbështetje shoqërisë “Raiffeisen Invest”, për ta shndërruar aktivitetin e administrimit të fondeve të investimeve në një aktivitet të suksesshëm dhe efikas, me një zbatim pozitiv në zhvillimin e tregut financiar jo-bankar.

Këshilli i Administrimit të shoqërisë “Raiffeisen Invest - shoqëri administruese e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive” argumenton:

- Investimi që do kryhet nga Banka “Raiffeisen” është në përputhje me prospektin dhe rregullat e Fondit “Raiffeisen Prestigj”.
- Vlerësimi i titujve që Banka “Raiffeisen” do përdorë për pagesën e kuotave të fondit do të bëhet në përputhje me çmimin e tregut dhe do të certifikohet nga auditori i pavarur, shoqëria KPMG Albania.

- Investimi në fond i Bankës “Raiffeisen” dhe i çdo investitori tjetër do menaxhohet duke shmangur çdo kusht favorizues për palët e lidhura.

Titujt (letra me vlerë të Qeverisë së R.SH) që do të përdoren për pagesën e kuotave të Fondit të investimit “Raiffeisen Prestigj” janë tituj që tregtohen në një treg të rregulluar dhe si rrjedhim është i mundur përcaktimi i saktë i çmimit të tyre.

Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Të miratojë pagesën në tituj (letra me vlerë të Qeverisë së RSH) të kuotave të fondit të investimit “Raiffeisen Prestigj” nga investitori Raiffeisen Bank, duke gjykuar në stimulimin dhe zhvillimin e fondeve të investimeve, me synim zhvillimin e tregut financiar në Shqipëri;
2. Pagesa në tituj e kuotave të fondit të investimit “Raiffeisen Prestigj” nga investitori Raiffeisen Bank do bëhet pas vlerësimit të çmimit të këtyre titujve nga auditori i pavarur, me qëllim përcaktimin e saktë të çmimit të tregut.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI